



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.170/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.04.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Alstezo” SH.A, në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me nr. REF-85657-02-02-2021, me objekt “Riparim, mirëmbajtje automjetesh për Spitalin Rajonal Gjirokastër”, me Fond limit/Vlera e pritshme e kontratës 3,802,600 (tre milion e tetëqind e dy mijë e gjashtëqind) Lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues:

“Alstezo” SH.A
Lagja “Kryengritja e Fierit”, Rruga Aulona, Fier

Autoriteti kontraktor:

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.02.2021 në sistemin e prokurimeve elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me nr. REF-85657-02-02-2021, me objekt “Riparim, mirëmbajtje automjetesh për Spitalin Rajonal Gjirokastër”, me Fond limit/Vlera e pritshme e

kontratës 3,802,600 (tre milion e tetëqind e dy mijë e gjashtëqind) Lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 15.02.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 23.02.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultojn si më poshtë vijon:

- Alstezo	2,647,800	I skualifikuar
- Kadiu	2,839,153	I kualifikuar
- Vilnik Motors	3,538,800	I kualifikuar

II.4. Në datën 23.02.2021 operatori ekonomik “Alstezo” ShPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

- *Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2, të seksionit 2.2 “Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, pasi bilanci i vitit 2018 nuk është i shoqëruar me Akt Ekspertizën (Raport auditimi) nga Ekspert Kontabël i Autorizuar, në kundërshtim me nenin 41 të ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”. Kjo, pasi Ofertuesi është në kushtet e përcaktimeve të gërmës “c” të dispozitës së mësipërme ligjore, dhe shoqërimi i bilancit të vitit 2018 me akt ekspertizën përkatëse nga ekspert kontabël i autorizuar, përbën detyrim ligjor.*

II.5. Në datën 01.03.2021 operatori ekonomik “Alstezo” ShPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- *Bilancet e tre viteve të paraqitura nga ana jonë së bashku me ofertën pra përkatësisht për vitet 2017,2018,2019 janë të certifikuara, të firmosura dhe vulosura nga autoritetet përkatëse tatimore sikurse kërkohet nga AK në DT me vulë të njomë dhe origjinale. Në momentin e dorëzimit dhe certifikimit të tyre nga ana e përfaqësuesit të shoqërisë Alstezo SH.A dhe audituesit detyrimisht çdo bilanc është i shoqëruar edhe me raportin e auditimit përkatës. Në momentin e ngarkimit në SPE të bilancet e viteve 2017 dhe 2019 ne i kemi paraqitur të shoqëruara në dokumente edhe raportin përkatës për vitin 2017 dhe 2019, ndërsa për rastin e bilancit të vitit 2018 për shkak të një lapsusi në skanim e sipër nuk është bashkëngjitur në procedurën e prokurimit bilanci me raportin e auditimit përkatës.*

- Pavarësisht këtij lapsusi të ndodhur në ngarkim të dokumenteve në SPE , theksojmë se një veprim i tillë nuk e zhvlerëson apo e tjetërson faktin e plotësimit të kriterit të vendosur në pikën 3.2.2 në kriteret e veçanta të kualifikimit lidhur me kërkesën për paraqitjen e bilancit të vitit 2018, d.m.th ky bilanc është i paraqitur me të gjitha të dhënat e sakta dhe i konfirmuar pra i i firmosur dhe vulosur nga autoriteti i Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier. Ky fakt nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në DT. Përvec këtij raporti i auditimit bashkëngjitur bilancit të vitit 2018 është një dokument shoqërues dhe i pandashëm i vetë pasqyrave financiare dhe dokumentacionit shoqërues të bilancit të vitit 2018, ndërkohë që sikurse përshkruhet edhe në Ekstraktin Historik të QKB , ne si shoqëri kemi një vijueshmëri të aktivitetit për vitin pasardhës 2019-2020-2021 për të cilin kemi dorëzuar së bashku me ofertën tonë edhe bilancin 2019 me raportin e auditimit përkatës të tij shoqëruar edhe me Ekstraktin Historik të QKB si dhe vërtetimet nga administrata tatimore për detyrimet dhe sigurimet.
- Raporti i auditimit të pasqyrave financiare ka qenë dhe është një kusht pa të cilin pasqyrat financiare nuk mund të pranohen nga QKB, pra nuk mund të dorëzohen dhe depozitohen në QKB, këto jana hapa njëra pas tjetrës pa respektimin e të cilave nuk mund të kalohet në depozitim të pasqyrave financiare. Ky fakt mund të verifikohet lehtësisht online nga ana juaj si AK në Ekstraktin Historik të QKB.
- Ndërkohë sikurse dihet shoqëritë aksionere e kanë të detyrueshme auditimin qoftë edhe me një vlerë 0 të aktivitetit të tyre d.m.th edhe pa ushtruar fare aktivitet. Më konkretisht shoqëria jonë jo vetëm që është audituar për bilancin në vitin 2018, por lidhur me këtë auditim është lëshuar raporti i auditimit si edhe është ngarkuar në QKB dhe faqen e tatimeve. Bashkëngjitur keni edhe raportin e auditimit dt 25.03.2019 (bashkëngjitur bilancit të vitit 2018) firmosur dhe vulosur nga autoriteti i Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, dorëzuar nga shoqëria Alstezo në faqen e tatimeve dhe në QKB.
- Sa më sipër duke marrë shkas edhe nga ankimi ynë ju si AK i keni të gjitha mudësitë dhe të drejtat për veifikimin dhe konfirmimin e saktë të këtij dokumenti duke u drejtuar autoritetit përkatës tatimor si dhe QKB, pasi janë pikërisht këto autoritete në të cilat është i depozituar raporti i auditimit për bilancin ekonomik të vitit 2018 të cilat nga ana e tyre e konfirmojnë në mënyrë kategorike paraqitjen dhe dorëzimin në kohë reale të këtij raporti si në faqen tatimore ashtu edhe në QKB.
- Argumentimin tonë e bazojmë gjithashtu në nenin 53 pika 4 e LPP. Sipas këtij neni është e drejta e AK që për një gjykim sa më të drejtë dhe jodiskriminues për plotësimin e cdo kriteri nga ana e OE pjesmarrës përpara shpalljes së klasifikimit përfundimtar të ofertave të bëjë verifikimin e të gjithë dokumentacionit ose të një dokumenti në rastin konkret bazuar në LPP dhe VKM dhe pas marrjes së këtij informacioni KVO të bëjë klasifikimin e ofertave për OE pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi.
- Sa më sipër kërkojmë rivlerësim të ofertës sonë.

II.6. Në datën 08.03.2021 me shkresën nr.478/2 prot operatori ekonomik ankimues ka marrë dijëni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 16.03.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.619/1 prot datë 29.03.2021 protokolluar me tonën me nr.417/2 prot datë 30.03.2021 me objekt “*Dërgohet informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” SH.A mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2, të seksionit 2.2 “Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar” të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi bilanci i vitit 2018 nuk është i shoqëruar me Akt Ekspertizën (Raport auditimi) nga Ekspert Kontabël i Autorizuar, në kundërshtim me nenin 41 të ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”. Kjo, pasi Ofertuesi është në kushtet e përcaktimeve të gjermës “c” të dispozitës së mësipërme ligjore, dhe shoqërimi i bilancit të vitit 2018 me akt ekspertizën përkatëse nga ekspert kontabël i autorizuar, përbën detyrim ligjor*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” , pika 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

- *Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:*

Kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: 2017, 2018, 2019 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të gjermës “c”, të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Alstezo” SH.A në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Pasqyrat financiare për vitin 2017 shoqëruar me raportin e audituesit ligjor.
- Pasqyrat financiare për vitin 2018
- Pasqyrat financiare për vitin 2019 shoqëruar me raportin e audituesve të pavarur

III.1.3. Në ligjin 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” neni 41 të ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare

Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:

a) të gjitha shoqëritë tregtare, pavarësisht nga forma e tyre, të cilat zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar;

b) të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit;

c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “c” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur. [...]”

III.1.5. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.1.6. Sa më sipër Komisioni konstaton se në kriterin e veçantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2017,2018,2019), të paraqitur në autoritetet përkatëse tatimore si dhe të shoqëruara me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi, Komisioni konstaton se janë dorëzuar pasqyrat financiare për vitet 2017, 2018, 2019, por vetëm pasqyrat financiare për vitin 2017 dhe 2019 janë të shoqëruara me Raportin e Audituesit të Pavarur ndërsa mungon ky dokument lidhur me pasqyrat financiare për vitin 2018. Ndërkohë referuar parashtrimeve në ankesë lidhur me përmbushjen e këtij kriteri ankimuesi argumenton se: *Në momentin e ngarkimit në SPE të bilancet e viteve 2017 dhe 2019 ne i kemi paraqitur të shoqëruar në dokumente edhe raportin përkatës për vitin 2017 dhe 2019, ndërsa për rastin e bilancit të vitit 2018 për shkak të një lapsusi në skanim e sipër nuk është bashkëngjitur në procedurën e prokurimit bilanci me raportin e auditimit përkatës.* Referuar bazës ligjore të sipërcituar parashikohet shprehimisht se: *Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: b) të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit.*

KPP gjykon se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit, përbën shkak për skualifikim në kuptim të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 e ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Alstezo” SH.A nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo ” SH.A për procedurën e prokurimit, “Kërkesë për Propozime”, me nr. REF-85657-02-02-2021, me objekt “Riparim, mirëmbajtje automjetesh për Spitalin Rajonal Gjirokastër”, me Fond limit/Vlera e pritshme e kontratës 3,802,600 (tre milion e tetëqind e dy mijë e gjashtëqind) Lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.02.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 417 Protokoli, Datë 16.03.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri